



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
KOMISIONI I PAVARUR AD-HOC

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

E-mail: info@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 27 Prot

Tiranë, më 23 / 4 /2024

VENDIM

Nr. 38 , Datë 22.4.2024

**PËR VIJIMIN E PROCEDURËS PËR VERIFIKIMIN E KRITEREVE
PROFESIONALE DHE MORALE TË KANDIDATIT SAIMIR KOLA PËR
POZICIONET VAKANTE: ANËTAR I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
DHE
ANËTAR I KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

Komisioni *Ad-Hoc* i përbërë nga:

Erinda BALLANCA	- kryetar
Sokol NGRESI	- zëvendëskryetar
Maksim HAXHIA	- anëtar (në mungesë)
Illir DODE	- anëtar
Shaban SINANI	- anëtar

në mbledhjen e datës **22.04.2024**, e thërritur nga Kryetarja e Komisionit të Pavarur Ad Hoc, znj. Erinda Ballanca, mori në shqyrtim çështjen që i përket kandidatit **SAIMIR KOLA**, për pozicionet vakante:

- anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe
- anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë

shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 19.07.2023¹.

Komisioni *Ad-Hoc*, pasi dëgjoji relatimin e kryetarit të Komisionit, lidhur me vendimmarrjen e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, përkatësisht vendimet nr.86-2023-1510, datë 28.12.2023), në vendimin nr. 6 (86-2024-44), datë 23.01.2024.

¹ Vendim i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit nr. 3, datë 19.07.2023.

si dhe kërkesave të shprehura nga përfaqësuesit e misionit OPDAT në Shqipëri, mision i cili ka monitoruar në vazhdimësi gjithë këtë proces,

VËREN:

1. Në vijim të procedurës së verifikimit paraprak të kandidatëve për pozicionet vakante anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Komisioni Ad-Hoc, shpalli më datë 7 dhjetor 2023 emrat e kandidatëve që plotësonin kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë si dhe emrat e kandidatëve që nuk i plotësonin këto kushte. Ndërkohë, për kandidatët që plotësonin kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Komisioni i Pavarur Ad-Hoc vendosi të vijojë më tej me fazën e vlerësimit të kriterëve profesionale dhe morale përmes zhvillimit të seancave dëgjimore.
2. Kandidati Saimir Kola, pas përfundimit të procedurës së verifikimit paraprak, rezultoi se nuk plotësonte kushtet dhe kriteret ligjore për të qenë anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Në këto rrethana, Komisioni i Pavarur Ad Hoc, me vendimin nr.19, datë 07.12.2023, vendosi skualifikimin e këtij kandidati.
3. Pas njohjes me vendimin e skualifikimit të nxjerrë nga Komisioni i Pavarur Ad Hoc, kandidati Saimir Kola e ka ankimuar këtë vendim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
4. Në vendimin nr.86-2023-1510, datë 28.12.2023, Gjykata Administrative të Apelit, Tiranë, pas shqyrtimit të çështjes ka vendosur ndër të tjera edhe pranimin e kërkesë padisë dhe shfuqizimin e vendimit nr.19, datë 07.12.2023, të Komisionit të Pavarur Ad Hoc. Vendimi nuk është shpallur i arsyetuar.
5. Pas dhënies së vendimit nr.86-2023-1510, të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, Komisioni i Pavarur Ad Hoc, në zbatim të këtij vendimi ka kryer një hetim tjetër administrativ për ti dhënë mundësinë paditësit/kandidatit që të vërtetonte përmbushjen e kushteve ligjore,² sipas standardit që ka vendosur ky komision për çdo

² Kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 19, shkronja 3, gërma "d" dhe nenin 117 shkronja 3, gërma "ç", të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, pasi paditësi vërteton më së miri bazuar në prova, përvojën 10 vjeçare si Avokat, duke shlyer rregullisht të gjitha detyrimet tatimore dhe ato financiare ndaj Dhomës së Avokatisë, në përputhje me nenin 19, shkronja 3, gërma "d" dhe nenin 117 shkronja 3, gërma "ç", të ligjit nr.115/2016.



kandidat pjesëmarrës në këtë proces. Komisioni i Pavarur Ad Hoc, në vijimësi i mbledhur për të përmbyllur fazën e vlerësimit të kandidatëve, ka vlerësuar të marrë masat e nevojshme për të rregulluar të metat e konstatuara në procedurën e ndjekur për vlerësimin e kandidatit Saimir Kola.

6. Pas përfundimit të procedurave ligjore në përmbyllje të fazës së vlerësimit të kandidatit Saimir Kola, Komisioni i Pavarur Ad Hoc, ka nxjerrë vendimin nr. 36, datë 29.12.2023, sipas të cilit ky kandidat skualifikohet për mosplotësim të kushteve ligjore për anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ky vendim i arsyetuar i është komunikuar kandidatit në datë 30.12.2023.

7. Pasi është njohur me vendimin nr.36, datë 29.12.2023, kandidati Saimir Kola ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, në datë 08.01.2024, ndaj këtij vendimi.

8. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me vendimin nr. 6 (86-2024-44), datë 23.01.2024, Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesë padisë si dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr. 36, datë 29.12.2023 të palës së paditur Komisioni i Pavarur Ad-Hoc « Për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve nga rradhët e avokatisë, për plotësimin e vakancave për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, pranë Avokatit të Popullit ». Vendimi nr.6 (86-2024-44), datë 23.01.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, i është komunikuar i arsyetuar institucionit të Avokatit të Popullit në datë 30 janar 2024.

9. Komisioni i Pavarur Ad-Hoc, në zbatim të vendimit nr. 6 (86-2024-44), datë 23.01.2024, të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, në ushtrim të kompetencave të tij të parashikuara në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe në pikën 1 dhe 7, të nenit 9, të "Rregullores për funksionimin e Komisionit të Pavarur Ad Hoc, për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve, për plotësimin e vakancave për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nga radhët e avokatëve", si dhe në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ku përcaktohet se kandidati i kualifikuar duhet t'i nënshtrohet procesit të vlerësimit të kriterëve profesionale dhe morale dhe të renditet në listën e kandidatëve, për qëllime të këtij verifikimi për kandidatin Saimir Kola, për pozicionet vakante: anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,



VENDOSI:

1. Vijimin e procedurës për verifikimin e kriterëve profesionale dhe morale të kandidatit Saimir Kola për pozicionet vakante: anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
2. Njoftimin e kandidatit Saimir Kola në rrugë elektronike për zhvillimin e seancës dëgjimore para Komisionit të Pavarur Ad Hoc, më datë 23.04.2024, ora 18.00, pranë ambienteve të institucionit të Avokatit të Popullit.
3. Ky Vendim i përmbledhur t'i komunikohet menjëherë kandidatit Saimir Kola.
4. Ndjekja e zbatimit të këtij Vendimi, të bëhet nga kryetari i këtij Komisioni.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


Avokati i Popullit
KRYETAR

Erinda BALLANCA




Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi
ZEVENDËSKRYETAR

Sokol NGRESI



Përfaqësues të Dhomës së Avokatisë
ANËTARË

Maksim HAXHIA



Përfaqësuesi i Akademisë së Shkencave
ANËTAR

Ilir DODE



Shaban SINANI

